



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	27.10.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	“Komiteti për imunizim të popullatës me vaksinë kundër Covid 19”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike
	Kontrollooi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën përmes e-mailit zyrtar nga “Komiteti për imunizim të popullatës me vaksinë kundër Covid 19” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosja e një tende në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 28 dhe 29 Tetor 2021 nga ora 10:00 deri në ora 17:30, në kuadër të vaksinimit të popullatës me vaksinë kundër Covid 19 ku është planifikuar që një ekupe mobile të vendoset në shesh dhe qytetarët të cilët nuk janë vaksinuar akoma të vaksinohen tani.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës tuaj, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe vendosjen e tendës në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 28 dhe 29 Tetor 2021 nga ora 10:00 deri në ora 17:30 me qëllim të realizimit të aktivitetit të lartshënuar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHIP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.